

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI DHE KOMISIONIT EVROPIAN, PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II, MALI I ZI - SHQIPËRI, ALOKIMET E VITIT 2016”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016.

Marrëveshja e financimit është miratuar në parim nga ana e Këshillit të Ministrave me vendimin nr.798, datë 29.12.2017, “Për miratimin për parim të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016”.

Marrëveshja është nënshkruar për palën shqiptare nga ana e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, në datën 29 dhjetor 2017.

Programi BNK Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020 u miratua nga Komisioni me vendimin zbatues C(2014) 9352 të datës 10 dhjetor 2014. Alokimet e vitit 2016 për këtë program financohen nga një grant i BE-së, nëpërmjet instrumentit IPA II, me një vlerë prej 1 700 000 (një milion e shtatëqind mijë) euro për të dyja vendet, por, duke marrë parasysh edhe bashkëfinancimin kombëtar të dy shteteve (300 000 (treqind mijë) euro bashkërisht), buxheti i përgjithshëm i programit për vitin 2016 arrin vlerën 2 000 000 (dy milionë) euro.

Sqarojmë se, në total, kontributi që do të japë BE-ja për zbatimin e përbashkët të programit Mal i Zi – Shqipëri, për periudhën 2014-2020, arrin vlerën 11 900 000 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind) euro por alokimet e mëtejshme do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare midis vendit tonë, Malit të Zi dhe Komisionit Evropian. Sjellim në vëmendje se dy marrëveshje të tjera financimi janë konkluduar ndërmjet palëve për të njëjtin program (për alokimet e viteve 2014 dhe 2015), të cilat janë ratifikuar edhe nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (ligji nr.31/2016).

Përfitues të këtij programi do të jenë zonat si më poshtë;

Në Mal të Zi: Andrijevisa, Berane, Petnjica, Plavë, Gucia, Rozhajë Podgoricë, Cetinje, Danilovgrad, Budva, Bar dhe Ulqin.

Në Shqipëri: Shkodra, Lezha, Rrethi i Tropojës.

Programi i bashkëpunimit Mal i Zi - Shqipëri ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Ky program mbështet gjithashtu në shkëmbimin e eksperiencës dhe të njohurive ndërmjet përfituesve, si dhe në përmirësimin e politikave publike mes autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në zonën e programit. Programi në fjalë mbulon një territor prej 11 970 km², me një popullsi rreth 749 257 banorë.

Duke marrë parasysh aspektet problematike që ndikojnë në ekonominë e zonës dhe zhvillimin e saj të qëndrueshëm, programi do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme tematike:

1. Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
2. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut;
3. Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe përfshirjes sociale e kulturore përtej kufirit.

Një tjetër aks prioritar do t'i dedikohet asistencës teknike prej rreth 1 190 000 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë) eurosh për të gjithë periudhën e zbatimit 2014-2020, për të dyja vendet, që përbën 10% të buxhetit të përgjithshëm të programit. Kjo asistencë do të përdoret kryesisht për zbatimin efektiv, transparent dhe në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar nga ana e strukturave kombëtare dhe atyre teknike.

Marrëveshja e financimit për këtë program përbëhet nga 9 pjesë:

- a) Kushtet e veçanta të marrëveshjes
- b) Shtojca I: Programi i veprimit CBC Mali i Zi - Shqipëri për vitet 2015 – 2017 - Vendim zbatues i Komisionit C (2015) 5235 i datës 22 korrik 2015;
- c) Shtojca IA: IPA II CBC 2014-2020, programi ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë;
- ç) Shtojca II: Kushtet e përgjithshme;
- d) Shtojca III: Raporti vjetor model CBC për zbatimin e asistencës IPA II në përputhje me nenin 80 të marrëveshjes kuadër;

- dh) Shtojca III A: Raporti vjetor model për zbatimin e asistencës IPA II në përputhje me nenet 58 e 59 (1) të marrëveshjes kuadër;
 - e) Shtojca IV: Modeli i raportit financiar, sipas nenit 59 (2) të marrëveshjes kuadër;
 - ë) Shtojca V: Specifikimet minimale të sistemit të kontabilitetit me bazë aktuale;
 - f) Shtojca VI: Masat *ad hoc* për besimin e detyrave të zbatimit të buxhetit nën këtë program.
- Programi i veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri për vitet 2015-2017 (shtojca I) përmban një përshkrim të modaliteteve të zbatimit të programit, përfshirë alokimet për secilin vit financiar, prioritetet e programit, kushtet e thirrjeve për projektpropozime dhe monitorimin e performancës së programit.
 - Programi i bashkëpunimit (shtojca IA) përmban një analizë të karakteristikave kryesore të territorit të lejueshëm e të prioritetëve dhe ofron një pasqyrë të sfidave të zhvillimit që rrethojnë zonën e programit, të cilat mund të trajtohen nëpërmjet projekteve të përbashkëta.
 - Një pjesë e rëndësishme e marrëveshjes janë edhe kushtet e përgjithshme (shtojca II), ku parashikohen përgjegjësitë dhe strukturat zbatuese të programit. Ky program do të zbatohet me menaxhim indirekt nga Mali i Zi dhe autoriteti kontraktues do të jetë Drejtoria e Financave dhe Administrimit të Fondeve të Ndihmës së BE-së (CFCU) në ministrinë malazeze të Financave.
 - Shtojcat III, III A dhe IV të marrëveshjes paraqesin modelet e raportit vjetor të zbatimit për secilin program të bashkëpunimit ndërkufitar, përfshirë dhe një raport të përbashkët për të gjitha programet e bashkëpunimit ndërkufitar që përfiton vendi ynë, pavarësisht zbatimit nën menaxhimin indirekt apo direkt nga ana e Komisionit Evropian.
 - Shtojca V parashikon kushtet që përfituesi IPA II duhet të plotësojë për ngritjen e sistemit të kontabilitetit.
 - Shtojca VI parashikon masat *ad hoc* për besimin e detyrave të zbatimit të buxhetit nën këtë program, përveç detyrave të përfituesit IPA II, që është autoriteti kontraktues lidhur me besimin e detyrave të zbatimit të buxhetit të parashikuar në këtë marrëveshje financiare, në veçanti shtojcën II.

Mali i Zi dhe Shqipëria do të bashkëpunojnë ngushtë për koordinimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programit. Struktura institucionale e programit është e përbërë nga autoriteti kontraktues i programit (Mali i Zi), Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, Sekretariati i Përbashkët Teknik, si dhe koordinatorët kombëtarë të fondeve IPA të të dyja vendeve përfituese.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji është parashikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje financiare do të mundësojë zbatimin e përbashkët të projekteve në të ardhmen midis Malit të Zi dhe Shqipërisë, duke u mundësuar në këtë mënyrë përfituesve nga të dyja vendet shkëmbimin e përvojës e të njohurive, duke prodhuar njëkohësisht rezultate të dukshme në sektorin e mjedisit, turizmit, trashëgimisë natyrore, punësimit etj.

Programi i bashkëpunimit Mali i Zi - Shqipëri ka reflektuar rëndësinë që BE-ja u kushton çështjeve horizontale dhe ndërsektoriale. Çështje të tilla janë reflektuar në të gjitha prioritetet e zgjedhura për programin, si krijimi i partneriteteve ndërkufitare, “autorësia” vendore dhe mundësitë e barabarta, garantimi i mosdiskriminimit të minoriteteve dhe të kategorive të cënueshme, pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile, mbrojtja e mjedisit, të drejtat gjinore etj. Programi është në përputhje të plotë me strategjinë e BE-së për rajonin e Adriatikut dhe të Jonit dhe të dyja vendet mund të zbatojnë projekte strategjike të përbashkëta në kuadër të strategjisë makrorajonale në të cilën bëjnë pjesë.

Lidhur me evidentimin e problematikave, ashtu si në çdo program tjetër të bashkëpunimit ndërkufitar, problematika kryesore pas miratimit të projektligjit, do të lidhet kryesisht me mundësitë dhe kapacitetet e përfituesve shqiptarë për përthithjen, hartimin e projektpropozimeve dhe zbatimin me sukses të projekteve të financuara nga ky program. Ndaj, në vazhdim, puna e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme do të fokusohet në mbështetjen e përfituesve shqiptarë për hartimin dhe zbatimin e suksesshëm të projekteve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj bazohet në nenet 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës. Procedura e ndjekur deri në propozimin e këtij projektligji është në përputhje të plotë me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Ky projektligj është në përputhje me ligjin nr.37/2015,

datë 9.4.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE

Ky projektligj nuk përafron në vetvete ndonjë akt të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji synon ratifikimin nga Kuvendi të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, për vitet 2015 - 2017, alokimet për vitin 2016, me një vlerë prej 2 000 000 (dy milionë) euro (përfshirë bashkëfinancimin), për të dyja vendet. Kjo vlerë do të përdoret për financimin e projekteve sipas akseve prioritare të paraqitura në pikën 1 të këtij relacioni. Projektet përzgjidhen pas një procesi transparent aplikimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ngarkohet për zbatimin e projektligjit, në cilësinë e koordinatorës kombëtare e asistencës së BE-së për Shqipërinë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ende nuk mund të shprehemi saktësisht në lidhje me efektet konkrete financiare në buxhet, por, duke marrë parasysh se përfitimi financiar i të dyja vendeve do të jetë përafërsisht i barabartë, pritet që vendi ynë të përfitojë shumën rreth 850 000 (tetëqind e pesëdhjetë mijë) euro nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje. Theksojmë se përfitues të këtij programi nuk do të jenë vetëm institucionet shtetërore buxhetore por edhe organizata e shoqata të tjera jofitimprurëse (të

cilat nuk ndikojnë në të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore). Sjellim në vëmendje se raporti i financimit të çdo projekti të financuar nga kjo marrëveshje (përveç projektit të asistencës teknike) është në raportin 85% grant i BE-së dhe 15% bashkëfinancim kombëtar.

KËSHILLI I MINISTRAVE